



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI



Nr. 1105/118 prot

Koplik më: 06 /05/2020

V E N D I M

Nr 28 datë 30 / 04 / 2020

PËR

”Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Angjelin Prronaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetasi nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për “emergjencat civile”

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr 45/2019 Për mbrojtjen civile

VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit Angjelin Prronaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për dëmtimin e shtëpisë.
3. T’i akordojë familjes së shtetasit Angjelin Prronaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe i vitit 2020.
4. T’i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit **Angjelin Prronaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t’i propozojë/kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e bashkisë.



5. Ndhimja financiare për familjen e shtetasit Angjelin Prronaj, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012.

6. Ndhimja financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Angjelin Prronaj**, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 658.300 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tete mije e treqind) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 3.335.106 (tre million e treqind e tridhjetë e pese mije e njeqind e gjashtë) leke.

Vlera në total e dëmeve është : 3.993.406 (tre million e nentëqind e nentëdhjetë e tre mije e katerqind e gjashtë) leke.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

9.U miratua më datë 30/04/2020.

10.U shpall me datë 04/05/2020.

SEKRETAR I KESHILLIT

Emirjan Hasmujaj



KRYETARI I KESHILLIT

Ilir Halaj